**NR: 03-310**
**18.11.2024**
**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/9 datë 18.11.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 42-të mbajtur me datë 15.11.2024 miratoi si vijon:

## Aktvendim
## për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV SHENJA SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 11 shtator 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, si dhe gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që transmetonte në periudhën nga ora 7,00 deri në orën 19,00.

   Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproj sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

## A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje të programit (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të pakos programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratur në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92, параграфёт (1) дхе (3) të ЛСХМААВ, схољёритё трегтаре радиодифузиве љё трансметојнё схёрбим програмор телевизив детsрохен гјатё дитёс të трансметојнё сё паку 30% програм të кријуар буримор си вепра аудиовизуеле маљедонасе осе вепра аудиовизуеле, ндёрса схёрбими публик радиодифузив сё паку 40%. Схољёритё Трегтаре Радиодифузиве љё трансметојнё схёрбим програмор телевизив, јанё të детsруар сё паку гјscмён е облигимит të пёрцактуара нё параграфин (1) të кётиј нени теи реализојнё нё периудхён нга ора 7,00 дери нё орён 19,00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 3 tetor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim), ku u konstatua se më 11 shtator 2024 shërbimi programor televiziv i SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, po ashtu dhe së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që transmetonte në periudhën nga ora 7,00 deri në orën 19,00.

Гјегјёсисхт, нга мбикёљърја ёсхтё констатуар се më 11 shtator 2024, shërbimi programor televiziv i SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, ka transmetuar 5 orë 9 minuta dhe 6 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është 27.37% e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (18 orë 49 minuta dhe 22 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetimin e programit të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 11 shtator që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (18:49:22) është 5 orë 38 minuta dhe 48 sekonda. SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup ka transmetuar për 29 minuta dhe 42 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase. Gjysma e minimumit ligjor (nga 05:38:48) është 2 orë 49 minuta dhe 24 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, koha minimale që është dashur të transmetohet në programin e SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00. Në këtë periudhë, siç është konstatuar nga mbikëqyrja, janë transmetuar 1 orë 28 minuta dhe 44 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që në këtë situate është për 1 orë 20 minuta dhe 40 sekonda më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drjetua SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, më 07.10.2024, dërgoi Shkresë me ark.nr.10-4093/2 datë 07.10.2024, ku dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarim me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 07.10.2024. Në afatin e parashikura, SHT TV SHENJA SHPKNJP Shkup, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.11.2024, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup t'i shqipton masën-paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4644/9 datë 18.11.2024, miratoi Aktvendimin ku paralajmëron publikisht SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa mësipër, u miratua aktvendim si në dipozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4093/1 datë 04.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike**
**Audio dhe Audiovizuele**
**Kryetari i Këshillit,**
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.